




REPublika e Kosovës REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot Prot No 01-3359/13
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 14.10.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.10.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-2640/13, për z. Nuhi Provoliu. – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Komunën e Kaçanikut, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, pasi që zyrtari në fjalë nuk ushtron më funksion publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-2640/13 që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Nuhi Provoliu, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Komunën e Kaçanikut, ku është dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Komunën e Kaçanikut, dhe angazhimit të tij në veprimari tjera private si pronarë dhe person i autorizuar në biznesin privat me emër N.T.SH. “Erb – Medicus” në Komunën e Kaçanikut.

Pas analizimit të gjendjes është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, pasi që z. Provoliu, nuk është më duke ushtruar pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Komunën e Kaçanikut, dhe nuk e ka statusin e zyrtarit të lartë publik sipas ligjit në fuqi, ky

fakt dëshmon se nuk kemi gjendje të konfliktit të interesit dhe nuk kemi situatë që dëshmon se ka shkelje të ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj duke vlerësuar gjendjen faktike konstatojmë se nuk ka elemente që dëshmojnë gjendjen e Konfliktit të Interesit, pasi zyrtari i lartë z. Nuhi Provoliu nuk ushtron funksionin publik dhe nuk e ka statusin e zyrtarit të lartë

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

